

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1.1 Hyrje**
- 1.2 Pozicioni i objektit**
- 1.3 Gjendja Ekzistuese**
- 1.4 Projekt-Zbatimi**



1.1. HYRJE

Bazuar ne detyren e projektimit dhe kerkesat e Investitorit, nga ana jone si shoqeri projektuese eshte pergatitur materiali i nevojshem teknik per projekt-zbatimin e infrastruktures se brendshme rrugore te fshatit Gose e Madhe.

Rrugët e brendshme të fshatit Gose jane pjese e Bashkise Rrogozhine.

Ne kete projekt-zbatim eshte parashikuar rikonstruksioni i dy rrugeve te brendshme te me gjatësi totale 1600 ml (1140 ml Dega Nr.1 dhe 460 ml Dega Nr.2).

Ndertimi i ketyre rrugeve te brendshme, siguron lidhjen e banoreve qe jetojne ne te dy anet e ketyre rrugeve me rrugën e vjeter nacionale Kavaje – Rrogozhine.

Ashtu sic u permend edhe me siper rruget e perfshira ne detyre projektimi me emertimin dhe gjatesite perkatese jane si me poshte vijon:

- | | | |
|--------------------------|----------------|--------------------|
| 1. Rruga "Dega 1" | gjatësi | L = 1140 ml |
| 2. Rruga "Dega 2" | gjatësi | L = 460 ml |

Ne planimetri rruga "Dega 1" fillon ne km 0+060 m dhe perfundon ne km 1+200. Zona nga km 0+000 deri ne 0+060 eshte pjese e nje projekti tjeter te Bashkise Rrogozhine. Këto rrugë në pjesën më të madhe të tyre shtrihen në zona te banuara, në të dy anët e të cilave ndodhen shtëpi banimi 1- 2 kate.



1.2. POZICIONI I OBJEKTIT

Objekti:

"Rikonstruksion i Rrugeve,"Qender Gose-Hekurudha-Gose e Madhe, Rrogozhinë"

Vendodhja : Bashkia Rrogozhine

Gjatësia : Rreth 1600 ml

1.3. GJENDJA EKZISTUESE

Gjendja ekzistuese e rrugeve te brendshme te fshatit Gose eshte totalisht e degraduar. Te gjitha keto rruge jane te paasfaltuara.

Keto rruge jane me rëndësi te madhe për lëvizjen e brendshme te banorëve të kësaj zone si dhe lidhjen e tyre me rrugen kombetare Kavaje-Rrogozhine.

Ky projekt parashikon ndertimin e rrugeve me te gjithë elementet e nevojshem rrugor.

Gjatesia ne total e rrugeve eshte rreth rreth 1600 ml. Nga rikonjicioni i realizuar nga grupi i projektimit u konstatua se gjendja ekzistuese e rrugeve eshte e degraduar, me gropezime te medha, cedime etj.

Ne te dy deget mungon rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza dhe te bardha.

Gjithashtu ne te gjithë gjatesine e rruges nuk ka rrjet te ndrcimit rrugor.



Foto. Gjendja Ekzistuese (Dega 1+ Dega 2)

1.4. PROJEKT-ZBATIMI

• TE DHENAT MBI PROJEKTIN


Ne projekt-zbatimi eshte parashikuar qe rruga te jete me gjeresi totale 5.5m, gjeresi e asfaltit 4m dhe dy bankina me gjeresi 0.75m.

Vetem ne degen Nr.1, ne zonen urbane km 0+060 deri km 0+280 eshte parashikuar qe trupi i rruges te kete gjeresi 6m dhe trotuar me gjeresi 1m. Rruga ka gjeresi asfaltike 5m, dy kuneta anesore me gjeresi 0.5m dhe trotuar me gjeresi 1m.


Paketa e shtresave rrugore eshte si me poshte vijon:

- Asfalt 3cm
- Binder 5cm
- Stabilizant 20cm
- Cakell 30cm


Trotuari eshte parashikuar te jete me pllaka betoni me trashesi 6cm, shtrese cakelli 20cm, shtrese betoni 10cm C16/20 dhe shtrese rere nen pllaka.



Planimetria (Rr. Dega 1)




Planimetria (Rr. Dega 1)



Profil terthor tip (Rruga "Dega 1")

Projekti do të plotësohet me kanalizimet e ujrave të shiut në km 0+060 deri km 0+280 në degen Nr.1 dhe në disa zona të Dehes Nr.2. Tubi i parashikuar për kanalizimet e ujrave të shiut është $\varnothing$ 315-600 mm. Në të gjithë gjatësinë e linjës së KUSH janë parashikuar puseta betoni me kapak kompozit me dimensione 60x40cm.

Distanca nga puseta në pusete është marrë 25m me përjashtim të rasteve të kthesave ose interseksioneve.



Planimetria e KUB

Gjithashtu në km 0+060 deri km 0+280 në degen Nr.1 është parashikuar vendosja e sistemit të kanalizimeve të ujrave të zeza.

Ky sistem është parashikuar me tub të brinjëzuar me diametër 400mm deri 600mm.

Përgjatë linjës së KUZ është parashikuar lidhja me të gjitha objektet në të dy anët, e cila realizohet me tub të brinjëzuar 200mm. Pusetat janë parashikuar 80x80cm beton/armer.




Planimetria e KUZ

Ne km 0+060 deri km 0+280 ne degen Nr.1 eshte parashikuar vendosja e sistemit te ndricimit rrugor. Jane parashikuar vendosje e shtyllave metalike me lartesi 7.8m me krah 1.5m.



Plani i Ndrimit

Ne projekt-zbatimi eshte parashikuar vendosja e sinjalistikes vertikale dhe horizontale. Eshte parashikuar vendosja e tabelave rrethore 40cm dhe trekendore 60cm, CI 2. Gjithashtu pergjate te gjithe rruges eshte parashikuar vendosja e pervijuesve te ktheses cift, tabela informacioni 125x25cm, tabele ure, tabele kembesoresh etj. Ne zonat ne te cilat bankina eshte e lire nga elementet kufizues jane parashikuar delineator. Ne zonat me disnivele eshte parashikuar vendosje e parrakeve metalik guard-rail N2/W4, ndersa tek veprat e artit eshte parashikuar H2/W5.



Plani i Sinjalistikes

Vijezimi horizontal gjatesor do te behet me boje Bikomponent Sprajt me trashesi 12cm. Vizimi per kalimet e kembesoreve si dhe vizimi STOP do te jete bikomponent paste.

Projekt-zbatimi eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e Investitorit dhe porositetit.

Per "InfraKonsult" sh.p.k

Ing.Redi Struga

